



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

---

Numri i lëndës: 2019:187409  
Datë: 19.03.2024  
Numri i dokumentit: 05469631

**C.nr.695/2007**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Fuad Haliti, në kontestin e paditësit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fahri Fazliu, kundër të paditurit B.SH nga Vushtrria, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.Rafet Ferizi nga Prishtina, me objekt kontestit kthim i borxhit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 19.03.2024, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

- I. **APROVOHET PJESËRISHT** si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK).
- II. **OBLIGOHET** i padituri B.SH, që paditësit t'ia paguajë borxhin në lartësi prej 77.98€, në emër të shpenzimit të energjisë elektrike, me kamatë prej 3.5%, nga dita e dorëzimit të padisë e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- III. **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), që të obligohet i padituri B.SH, që t'ia paguaj borxhin në lartësi prej 10,020.54€, në emër të shpenzimit të energjisë elektrike, si e pabazuar për shkak të parashkrimit.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

### **Arsyetim**

#### **1. Pretendimet e palëve**

Paditësi Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me datën 26.09.2007, pranë kësaj gjykate ka paraqitur Propozim për Ekzekutim, kundër B.SH, për pagesën e borxhit në lartësi prej 10,098.52€, të cilin propozim gjykata e ka lejuar, mirëpo pas kundërshtimit të të paditurit, me konkluzionin e datës 30.11.2007, është shfuqizuar aktvendimi për lejimin e përmbarimit dhe propozimi është konsideruar si padi.

Në seancën kryesore, i autorizuari i paditësit deklaroj mbesim pranë propozimit për ekzekutim tani të konsideruar padi dhe i propozojmë gjykatës që pas administrimit të provave ta aprovon të

njejtën në tërësi si të bazuar. E precizojmë padinë duke kërkuar që të obligohet i padituri të paguaj shumën prej 10,098.52 euro për periudhën 31.07.2002 deri më datën 22.09.2007 me kamatë ligjore nga dita e propozimit 26.09.2007.

Në seancën kryesore i autorizuari i të paditurit deklaroj, kundërshtojmë në tërësi propozimin për përmbarim apo tash padinë e parashtruar ndaj të përfaqësuarin tim z. B.SH lidhur me propozimin për përmbarim për borxh ndaj KEK-ut pasi që në këtë çështje kontestimore mungon legjitimiteti i palëve duke pasur parasysh faktin se paditësi përveç faturave në asnjë formë tjetër nuk ka mundur ta vërtetoj se i njëjti ka jetuar aty. Ne jemi të vetëdijshëm që pas luftës ka pasur fushata dhe propaganda të ndryshëm me të cilën janë dhënë edhe epitete tu i ba pronarë të objekteve, banesave të ndryshëm vetëm e vetëm se këta kanë qenë pjesëmarrës në luftë. Në opinionin publik në atë kohë të gjithë e kanë njohur si banesa e B.SHt komplet kompleksin dhe çka kish ndodh nëse të gjitha orat ishin kanë të regjistruara në emër të B.SHt a është dashur që të gjitha ato fatura të bien barrë B.SHt, nëse e shikojmë kohën kur B.SH ka jetuar është në këtë banesë – 1999 - 2003, edhe pse ka qenë koha kur KEK-u nuk ka mundur ti inkasoj as 30% të shpenzimeve të konsumatorëve të saj e për B.SHn në atë kohë ka qenë shumë e lehtë që të mos e paguaj asnjë faturë, por ky ka qenë shumë i përgjegjshëm në bazë të provave të cilat i ka edhe paditësja B.SH ka paguar faturat në kohën sa ka qenë shfrytëzues i banesës në fjalë. Banesën të cilën njehëtori i saj është kontestues në këtë çështje kontestimore i padituri e ka dorëzuar në posedim të disa familjarëve të tij pasi që nuk kishin streh në kokë dhe duke mos qenë pronar i asaj banese në atë kohë nuk ka qenë barrë dhe përgjegjësi e tij që të bëjë identifikimin e shpenzuesve apo ndryshimin e titullarit të orës si matëse e shpenzimit të energjisë elektrike. Në bazë të një dokumenti të cilin e ka marrë nga gjendja civile ku tregohet historia e qytetarit të vendbanimi të tij të cilën do ua përcjelli me parashtrësë rezulton se për kohën kur është ngarkuar për borxh ndaj KEK B.SH nuk ka jetuar në Mitrovicë. andaj po ashtu me përgjegjësi të plotë morale dhe penale i përfaqësuari ime kundërshton këtë nënshkrim në prapësimin ndaj propozimit për përmbarim pasi që formën e nënshkrimit e ka të ndryshëm dhe nuk i përputhet me të tijin.

Sa i përket periudhës së ngarkesës së borxhit për periudhën 2002 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2003 borxhi është parashkruar pasi ka kaluar tri vite me propozimin për përmbarim nga paditësja ndaj të paditurit kurse pjesa tjetër nuk është borxh i tij për shkak të arsyeve të cekura në procesverbal, andaj duke marrë për bazë deklarimet në procesverbal të kësaj seancë kërkojmë nga gjykata që padinë e paditësit ta hudhë si të pabazuar.

## ***2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor***

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: Fatura e datës 07.09.2007, nr.1921138 për DMI9021136, transaksioni i konsumatorit nga data 31.07.2002 e deri me datën 09.06.2023 dhe historia e qytetarit B.SH.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të LPK-së, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku duke gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **pjesërisht e bazuar**.

## ***3. Faktet***

Me leximin e faturës së datës 07.09.2007, nr.1921138 për DMI9021136 dhe transaksioni i konsumatorit nga data 31.07.2002 e deri me datën 09.06.2023, gjykata vërtetojë faktin se borxhi i të paditurit ndaj paditësit deri me datën e 22.09.2007, periudhë deri në të cilën paditësit kërkon pagesën e borxhit është në lartësi prej 10,098.52€.

Me leximin e historisë së qytetarit B.SH, gjykata vërtetojë faktin se i njëjti gjatë periudhës 09.12.2013 e deri me 22.04.2015 ka jetuar në Vushtrri dhe tani më Prishtinë.

#### **4. Ligji i aplikueshëm**

Në bazë të nenit 262 paragrafi 1 i LMD-së, parashihet që *“Kreditori në raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij.”*

Në bazë të nenit 378 paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i vitit 1978 (tutje LMD), parashihet që *“Parashkruhen për një vjet:kërkesa e kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e spastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi, respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake.”*

#### **5. Vlerësimet përfundimtare të gjykatës**

Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar pjerërisht.

Gjykata vlerëson se obligimi i të paditurit për pagesën e borxhit në emër të shpenzimit të energjisë elektrike është parashkruar për pjesën para datës 26.09.2006, kjo sepse në bazë të nenit 378 paragrafi 1 të LMD, kërkesat për kompensimin e shpenzimeve të energjisë elektrik parashkruhen në afatin një veçar, andaj duke pasur parasysh se padia është ngritur me datën 26.09.2007, ku me këtë rast është ndërprerë afati i parashkrimit, atëherë i padituri ka për obligim ta paguaj vetëm borxhin për periudhën nga data 26.09.2007 e deri me 26.09.2006, që i bie në lartësi prej 77.98€.

Gjykata, vlerëson se pretendimet e të paditurit se i njëjti nuk ka jetuar në banesën në të cilën ndodhet njëtori i energjisë elektrike DMI9021136, janë të pabazuara sepse i njëjti nuk arriti ta vërtetojë një gjë të tillë dhe njëtori i energjisë elektrike DMI9021136 është në emër personal të B.SH dhe nga historia e qytetarit nuk arriti të vërtetojë faktin se ku ka jetuar para periudhës 09.12.2013.

Lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata vendosi komfor nenit 463 të LPK-së, duke marrë parasysh se asnjëra palët ndërgjyqëse nuk i kërkojë shpenzimet e procedurës.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**  
**C.nr.695/2007, datë 19.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Fuad Haliti**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjës së të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.